



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic Prosecution



Numri i dokumentit: 03026817

ZYRA E PRANIMIT

KASTRIJOT ASLLANI më datën 02.04.2024 në ora 14:17 në Prokuroria Themelore Prishtine dorëzoi këto dokumente:

Lloji i dokumentit	Nr. i dokumentit	Data e dokumentit	Nr. i faqeve
Kallëzim Penal		02.04.2024	105

Tjera: KOSOVA MED

Dorëzoi:


04/02/2024 02:10:52 pm

KASTRIJOTASLLANI

Pranoi:


04/02/2024 02:10:52 pm

Besnik Halimi

PROKURORORIA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA		
PROKURORIA I SHTETIT - DRËZAVNI TUŽILAC		
Prokuroria Themelore Osnovno Tužilaštvo		
Pranuar	02 -04- 2024	Primijeno
Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Konshkrimi pranimit Potpis primaoca

Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (me tutje KPPRK), Kastriot Asllani, përfaqësues i autorizuar në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë tregtare KosovaMed Healthcare SHPK, me numër unik identifikues 810866759, me seli në Prishtinë, rruga Ndue Përlleshi K.P. Lok. Nr.1, ushtron këtë:

KALLËZIM PENAL

KUNDËR:

1. Hikmete Blakqori, inspektore shëndetësore në Inspektoratin Shëndetësor të Republikës së Kosovës.
2. Nysret Kuleta, inspektor shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor të Republikës së Kosovës.
3. Nora Kursani Demjaha, Zëvendësues i Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor të Republikës së Kosovës.

SEPSE

I

Ekziston dyshim i arsyeshëm se e dyshuara Hikmete Blakqori, duke e shfrytëzuar (shpërdorur) detyrën zyrtare, me datë 27.10.2023, pavarësisht që e dyshuara nuk ishte prezente në inspektim, e as nuk e përpilojë Procesverbalin e Inspektimit, ajo përpilon raport inspektimi specifik për KosovaMed Healthcare SHPK, dhe po ashtu në të njëjtën ditë bie vendim të kundërligjshëm me të cilin vendim kompanisë KosovaMed Healthcare SHPK i ndalon ushtrimin e veprimtarisë deri në licencim nga Ministria e Shëndetësisë për

shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Shëndetësi dhe po ashtu i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 10,000.00 Euro, duke i shkaktuar dëm personit juridik KosovaMed Helathcare SHPK me rastin e ndërprerjes së veprimtarisë legjitime, po ashtu dëm i është shkaktuar personelit të angazhuar në QKMF në Drenas me rastin e ndërprerjes së veprimtarisë dhe i është mohuar realizimi i të drejtës në punë stafit të angazhuar nga kompania KosovaMed Helathcare SHPK, po ashtu nga veprimi i të dyshuarës Hikmete Blakqori dëm i është shkaktuar edhe pacientëve të cilët kanë marrë shërbime nga kontrata kornizë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, kontratë e lidhur në mes të Komunës së Drenasit dhe KosovaMed Healthcare SHPK.

Njëkohësisht, e dyshuara, në të njejtën ditë (27.10.2023), **realizon vizitë në QKMF – Klinikë**, ku përpilon një Procesverbal përmes të cilit i ndalon punën dhe i urdhëron punëtorët e KosovaMed Healthcare SHPK, të cilët ishin duke kryer punë në bazë të kontratës kornizë, që të ndalojnë punën **deri në sqarimin e situatës**, në këtë mënyrë i mohon realizimin e të drejtës në punë punëtorëve dhe po ashtu të njëjtëve dhe kompanisë i shkakton dëm material.

Me këto veprime e dyshuara Hikmete Blakqori ka kryer veprën penale Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar, vepër e paraparë me nenin 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

II

Ekziston dyshim i arsyeshëm se Nysret Kuleta, në cilësinë e inspektorit shëndetësor, me rastin e inspektimit në QKMF në Klinikë, me datë 27.10.2023 me procesverbal i urdhëron punëtorët e KosovaMed Healthcare SHPK, të cilët ishin duke kryer punë në bazë të kontratës kornizë, që të ndalojnë punën deri në sqarimin e situatës, në këtë mënyrë i mohon realizimin e të drejtës në punë punëtorëve dhe po ashtu të njëjtëve dhe kompanisë i shkakton dëm material. I njëjti, më datë 11.10.2023 ishte në inspektim në QKMF – Drenas, së bashku me Dr. Hikmete Blakqori.

Me këto veprime i dyshuari Nysret Kuleta ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar, vepër e paraparë me nenin 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

III

Ekziston dyshim i arsyeshëm se e dyshuara Nora Kursani Demjaha, zëvendësuese e detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor të Republikës së Kosovës, me mos veprim, nuk i harmonizon veprimet e inspektorëve shëndetësorë në lidhje me veprimtarinë e KosovaMed Healthcare SHPK, ku disa inspektorë me rastin e inspektimit në komunën e Malishevës, komunën e Skenderajt konstatojnë se veprimtaria e kompanisë është e ligjshme, për dallim prej inspektorëve të tjerë në komunën e Drenasit dhe komunën e Klinës, të cilët për veprimtarinë e njëjtë të ushtruar nga ana e KosovaMed SHPK gjejnë gjoja parregullsi dhe për shkak të këtyre parregullsive i ndalojnë veprimtarinë, duke shkaktuar dëme materiale kompanisë, të punësuarve dhe pacientëve të cilët kanë marrë shërbime nga ky projekt, dhe po ashtu duke ju mohuar realizimin e të drejtës në punë personelit të angazhuar nga kompania KosovaMed SHPK dhe pacientëve iu mohohet e drejta e përfitimeve të shërbimeve shëndetësore.

Me këto veprime e dyshuara Nora Kursani Demjaha ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar, vepër e paraparë me nenin 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

IV

Ekziston dyshimi i arsyeshëm që Nora Kursani Demjaha, me veprim, dërgon email zyrtar, drejtuar Drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Drenas-it, dhe e urdhëron Drejtoreshën që të mos lejojë vazhdimin e Kontratës Publike Kornizë me të Dëmtuarin, duke e ditur që i Dëmtuari ka parashtruar Ankesë kundër Vendimit të Inspektoriatit Shëndetësor dhe se Ankesa e pezullon efektin juridik të Vendimit të Inspektoriatit Shëndetësor, si shkallë e parë, deri sa të vendoset përfundimisht nga Shkalla e Dytë.

Me këtë veprim, e dyshuara Nora Kursani Demjaha ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar, vepër e paraparë me nenin 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

ARSYETIMI

Komuna e Drenasit, si autoritet kontraktues, paraqet Njoftimin për Kontratën Kornizë të Ofritit të Shërbimeve Shëndetësore – Shërbimi Paliativ, duke rregulluar në detaje kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje në këtë projekt.

Në Qershor të vitit 2021, KosovaMed Healthcare SHPK, e dorëzon projektin e saj, në përputhje me Kushtet e Njoftimit dhe me datë 18.06.2021, KosovaMed Healthcare SHPK si Operator Ekonomik dhe Komuna e Drenasit si Autoritet Kontraktues, nënshkruajnë Kontratën Publike Kornizë, me numër 611-21-2552-2-1-1/C430. Me këtë kontratë është fare e qartë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga Operatori Ekonomik, staf të kualifikuar mjekësor për tu angazhuar në kuadër të QKMF-Drenas.

Shtojcë nr.1 këtij kallëzimi i bashkëngjisim kontratën publike kornizë me numër 611-21-2552-2-1-1/C430, nga e cila veçojmë pjesët si në vijim:

Aktiviteti 1.2.4: “Blerja e shërbimeve për personel shëndetësor përmes bashkëfinancimit me ndonjë OJQ apo OE dhe Komunës së Drenasit për vitin 2021 (5 Mjekë, 10 Infermierë dhe 2 shoferë.

Pikat kyçe të projektit, OE do të ofrojë stafin adekuatë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për shëndetin oral në institucionet KPSH ku ka nevojë me theks të veçantë shërbimeve shëndetësore në shtëpi.

Operatori Ekonomik rekomandohet të angazhojë në projekt minimum: 17 punëtorë (4-Mjekë, 1-Stomatolog, 1-Laborant dentarë asistent i stomatologut, 9-infermierë dhe 2-shoferë, që të gjithë të pajisur me licencën e punës profesionale.

Nga kontrata e lidhur mes Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik, shihet qartë se qëllimi i këtij projekti është që të ofrohet një shërbim publik dhe në asnjë mënyrë nuk bëhet fjalë për ofrimin e ndonjë shërbimi privat shëndetësorë. Pra ky është një projekt shumë specifik, i planifikuar, organizuar dhe financuar nga Komuna e Drenasit për qytetarët e saj si pjesë e shërbimeve publike shëndetësore në kuadër të QKMF-Drenas, dhe vet metodologjia e projektit ka përcaktuar fare qartë se i gjithë aktiviteti ofrohet në kuadër të QKMF – Drenas.

Në lidhje me të dyshuarën Hikmete Blakqori, sqarohet se me datë 11.10.2023, në zyret e KosovaMed Healthcare SHPK, janë paraqitur dy inspektore shëndetësore dhe atë Dr. Avdiqe Mala dhe Dr.Fakete Haziri, të cilat pas inspektimit, konstatojnë gjendjen që KosovaMed Healthcare SHPK nuk ka nevojë të pajiset me Licencë nga Ministria e

Shëndetësisë, dhe se kompetent për inspektim të kësaj Kompanie, është Inspektoriati i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Lidhur me këtë, Inspektoret Shëndetësore nuk përgatisin procesverbal, sepse konsiderojnë se nuk janë kompetente dhe e njoftojnë Inspektoriatin e AKPPM, të cilët paraqiten në zyret e KosovaMed Healthcare SHPK menjëherë dhe nxjerrin një Raport Inspektimi, ku specifikohet që KosovaMed Healthcare SHPK, është e pajisur me licensë nga AKPPM-ja.

Shtojcë nr.2 i bashkëngjishim procesverbalin e inspektorëve të AKPPM-së të datës 11.10.2023.

Pavarësisht që më datë 11.10.2023, Inspektoret Shëndetësore konstatuan që nuk janë kompetente për inspektimin e KosovaMed Healthcare SHPK, me datë 17.10.2023, Inspektorët Shëndetësorë Dr. Advije Mala dhe Dr. Fakete Haziri, sërish inspektojnë selinë e KosovaMed Healthcare SHPK, dhe përpilojnë procesverbalin me numër 02450, inspektimit bëhet me qëllim të konstatimit të faktit se a ka licensë institucioni për punëtorët e angazhuar në QKMF Drenas. Është ofruar licenca e lëshuar nga AKPM. Këtë Procesverbal e nënshkruan vetëm Dr. Avdije Mala, ndërkaq Dr. Fakete Haziri nuk e nënshkruan.

Shtojcë nr.3 këtij kallëzimit penal, procesverbalin me numër 02450 i datës 17.10.2023.

Me datë 18.10.2023, KosovaMed Healthcare SHPK, duke vepruar në përputhje me kërkesat e vendosura nga inspektimi dhe sipas procesverbalit 02450, gjatë takimit të mbajtur në zyrat e Inspektoratit Shëndetësor, ofron të gjitha dokumentet në lidhje me implementimin e projektit në QKMF Drenas, dhe i njofton inspektorët, që KosovaMed Healthcare SHPK nuk ka nevojë të pajiset me licensë nga Ministria e Shëndetësisë, për arsye se shërbimet të cilat i ofron mbi bazën e Kontratës Kornizë të lidhur me komunën e Drenasit, nuk ka nevojë që të jetë i licencuar.

Po ashtu dua të cekë se të gjithë punëtorët e KosovaMed Healthcare SHPK, të cilët operojnë në bazë të Kontratës Kornizë në komunat e ndryshme, duke e përfshi edhe komunën e Drenasit janë të pajisur me licenca valide të punës, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë.

E dyshuara Hikmete Blakqori, duke e shfrytëzuar detyrën zyrtare, me datë 27.10.2023, nxjerrë raport inspektimi, dhe atë për SPSH KosovaMed Healthcare SHPK, ku konstaton fakte krejtësisht të paqëndrueshme dhe qëllimisht të gabuara për institucionin, duke e konsideruar veprimtarinë e KosovaMed-it si subjekt i pavarur shëndetësor, e që në realitet nuk është e saktë dhe për më shumë është shpjeguar në takimin e datës 18.10.2023 se nuk jemi subjekt i pavarur shëndetësor. Po ashtu në këtë raport, inspektorja Hikmete Blakqori thirret në disa nene të Ligjit për Shëndetësi, të cilat nuk përkojnë fare me gjendjen faktike në raportin kontraktual ndërmjet QKMF Drenas dhe KosovaMed Healthcare SHPK. Shtojca nr.4 këtij kallëzimi penal, raporti i inspektimit i datës 27.10.2023. Në këtë takim, ishte prezent edhe i Dyshuari nr. II – Nysret Kuleta.

Shoqëria tregtare, KosovaMed Healthcare SHPK, ka ofruar shërbime në QKMF Drenas në bazë të Kontratës Kornizë, por jo si spital, përkatësisht jo si institucion shëndetësor privat qoftë spitalor apo ambulantiv të asnjë niveli shëndetësor. Pra, e dyshuara e ngatërron subjektin e inspektuar me subjekt privat shëndetësor. Subjekti KosovaMed Healthcare SHPK nuk ka qenë asnjë herë subjekt privat shëndetësor, dhe as që ka pasur apo ka një veprimtari të tillë. Në fakt as nuk ka tentuar ndonjë herë që të operojë si subjekt privat shëndetësor dhe nuk është paraqitur asnjë herë si subjekt i tillë, as në raportet private mes subjekteve privatë dhe as në raport me institucionet publike, qoftë ato të nivelit qendrorë apo të nivelit lokal.

E dyshuara në raport, i keqinterpreton faktet duke ju referuar procesverbalit të datës 11.10.2023, me numër rendor 01251 (në QKMF Drenas), i cili potencon që në kohë e inspektimit, disa mjekë të angazhuar nga KosovaMed Healthcare SHPK, ishin duke i shfrytëzuar hapësirat dhe asetet e QKMF Drenas, duke mos e përmendur fare kontratën kornizë në bazë të së cilës profesionistët shëndetësor ishin duke ushtruar veprimtari në QKMF Drenas, për të kryer shërbime shëndetësore.

Shtojcë nr.5 Procesverbali mbi inspektimin e kryer me numër 01251 i datës 11.10.2023.

Po ashtu e dyshuara Hikmete Blakqori në pikën 3 të raportit shtjellon procesverbalin e datës 17.10.2023 me nr. 02450, ndër të tjera konstaton se KosovaMed Healthcare SHPK nuk ka dorëzuar licencë si institucion që punëson mjekë në QKMF. Një konstatim i të dyshuarës është absurd për shkakun se në bazë të legjislacionit aktual të Republikës së

Kosovës nuk kërkohet të ketë licencë specifike një Kompani për punësim të mjekëve dhe ofrimin e shërbimeve të tyre në një QKMF. QKMF në Drenas është vet institucioni që ka të gjitha autorizimet ligjore dhe licencat e nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi për territorin e komunës së saj.

E dyshuara Hikmete Blakqori, nxjerrë vendimin me nr. 10/H-10-23, të datës 27.10.2023 dhe sipas pikës një të dispozitivit të këtij vendimi KosovaMed Healthcare me seli në rr. Ndue Përlleshi K.P Lokali numër 1, i ndalon ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore deri në licencim nga Ministria e Shëndetësisë dhe i shqiptohet gjoba në vlerë prej 10,000 Euro. Andaj, nga të lartë cekurat e dyshuara Hikmete Blakqori, duke e keqpërdorë pozitën e sajë bie vendim për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, duke u bazuar në fakte të pa sakta, e duke mos marrë parasysh faktet të cilat flasin bindshëm se operatori ekonomik KosovaMed Healthcare SHPK nuk ka nevojë të pajiset me licencë nga Ministria e Shëndetësisë, për ushtrimin e veprimtarisë për përmbushjen e kontratës të lidhur me Komunën e Drenasit.

Në lidhje me të dyshuarin Nysret Kuleta, i cili ishte i pranishëm në takimin e organizuar me datë 18.10.2024, në Inspektoratin Shëndetësor në Prishtinë, dhe i cili ishte në njohuri për çështjen që ndërlidhet me KosovaMed-in dhe QKMF Drenas, i njëjti me datë 27.10.2023 duke e keqpërdorë pozitën e tij paraqitet në komunën e Klinës dhe me procesverbal i urdhëron punëtorët e KosovaMed-it, të cilët ishin duke kryer punë sipas Kontratës Kornizë, që të ndalojnë punën deri në sqarimin e situatës, në këtë mënyrë i mohon realizimin e të drejtës në punë punëtorëve dhe po ashtu të njëjtëve dhe kompanisë KosovaMed i shkakton dëm material. I njëjti, më datë 15.11.2024, nxjerrë Raportin e Inspektimit, përmes të cilit e rekomandon ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, njësojë sikurse e Dyshuara Hikmete Blakqori. Në të njëjtën ditë, e dyshuara III Nora Kursani Demjaha, nxjerrë Vendim për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë.

Këtë veprim i dyshuari Nysret Kuleta e ndërmer duke e keqpërdorë pozitën e tij të inspektorit shëndetësor për shkakun se nuk kishte bazë ligjore dhe as praktikë që veprimtaria e bazuar në Kontratën Publike Kornizë të ndërpritet. Kontratë e lidhur po ashtu në mes të Komunës së Klinës dhe KosovaMed Healthcare SHPK.

Shtojcë nr.6 Vendimi me nr. 10/H-10-23, i datës 27.10.2023 për QKMF – Drenas, Vendimi me nr. 10/NY-104-23 dt. 15.11.2023 për QKMF – Klinë dhe Raporti i Inspektimit në QKMF – Klinë.

Më duhet të cekë se kam ushtruar ankesë në këtë vendim, dhe shkalla e dytë, komisioni për shqyrtimin e ankesave kundër vendimit të Inspektoratit Shëndetësor, më ka aprovuar ankesën dhe ka konstatuar si në vazhdim, citoj: “Pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga përfaqësuesi i kompanisë “KosovaMed Healthcare” SHPK me seli në Prishtinë, dhe administrimit të provave, që janë: Certifikata e Regjistrimit të Biznesit të “KosovaMed Healthcare” SHPK të lëshuar nga ARBK, licencat e stafit shëndetësorë të angazhuar nga “KosovaMed Healthcare” SHPK Prishtinë në QKMF Drenas, Kontratën Kornizë me QKMF Drenas. Komisioni për Shqyrtimin e Ankuesve ka konstatuar se “KosovaMed Healthcare” SHPK Prishtinë, është kompani tregtare e licencuar nga AKPM për shitblerjen e pajisjeve medicinale dhe ofrim të **kuadrove profesional medicinal** në institucione shëndetësore të licencuara. Prandaj shkelja e konstatuar nga Inspektorati Shëndetësor për mungesë licence valide të punës së insitucionit shëndetësor të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, është i gabuar dhe e pa bazuar, nga se kompania “KosovaMed Healthcare” SHPK Prishtinë, **nuk është institucion shëndetësor**, dhe se nuk ofron shërbime shëndetësore në selinë e saj dhe as në ndonjë objekt tjetër të sajë, e cila në këtë rast sipas kontratës ka angazhuar staf profesional shëndetësor e të licencuar, në QKMF në Drenas, gjë që angazhimet e tilla përfshihen me nenin 18 par.11 të Ligjit për Shëndetësi 04/L-125, “me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunim ndërsektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, e shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare”.

Shtojcë nr.7, Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e ankesave të Inspektoratit Shëndetësor me nr.10/KA-001/24 i datës 19.01.2024.

E dyshuara Hikmete Blakqori, duke e keqpërdor pozitën e saj i ka shkaktuar dëm personit juridik KosovaMed Helathcare SHPK me rastin e ndërprerjes së veprimtarisë legjitime, po ashtu dëm i është shkaktuar personelit të angazhuar në QKMF në Drenas me rastin e ndërprerjes së veprimtarisë dhe i është mohuar realizimi i të drejtës në punë stafit të

angazhuar nga kompania KosovaMed Healthcare SHPK, po ashtu nga veprimi i të dyshuarës Hikmete Blakqori dëm i është shkaktuar edhe pacientëve të cilët kanë marrë shërbime nga kontrata kornizë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, kontratë e lidhur në mes të Komunës së Drenasit dhe KosovaMed Healthcare SHPK.

Me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punëtorëve të angazhuar në bazë të kontratës publike kornizë, kam vazhduar me pagesën e pagave për punëtorët e angazhuar në QKMF Drenas për dy muaj dhe atë për muajin tetor dhe nëntor, dhe atë me datë 09.11.2023 dhe datë 12.12.2023 kam bërë transferin e mjeteve për këta dy muaj, edhe pse nga QKMF Drenas nuk jemi paguar nga shtatori i 2023.

Shtojcë nr.8 dëshmia e pagesës së pagave për dy muaj për punëtorët e angazhuar nga KosovaMed.

E dyshuara Nora Kursani Demjaha, zëvendësuese e detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor të Republikës së Kosovës, me mos veprim, nuk i harmonizon veprimet e inspektorëve shëndetësorë në lidhje me veprimtarinë e KosovaMed Healthcare SHPK, veprimtari kjo e bazuar në Kontratën Publike Kornizë e lidhur me disa komuna në Republikën e Kosovës, edhe pse të gjitha procesverbalet e kontrolleve nga ana e inspektorëve shëndetësorë dërgoheshin te e njëjta, prapë se prapë në disa komuna pas kontrollit të inspektorëve shëndetësorë konstatohej se nga KosovaMed Healthcare SHPK nuk ka shkelje në lidhje me implementimin e Kontratës Publike Kornizë, siç është komuna e Malishevës dhe Komuna e Skenderajt, ndërsa në Komunat tjera, si në komunën e Drenasit dhe Komunën e Klinës, konstatoheshin shkelje me rastin e kontrollit nga ana e inspektorëve shëndetësorë, në lidhje me implementimin e programit të njëjtë i cili buronte nga Kontratat Publike Kornizë të lidhura me këto komuna.

Andaj, e dyshuara në vend se të koordinoj punën e inspektorëve shëndetësor dhe të unifikoj politikat e veprimeve të inspektorëve shëndetësor, nuk e ndërmerri një veprim të tillë edhe pse nga pozita e saj është e obliguar ti ndërmerre këto veprime, por përkundrazi inspektorët shëndetësor veprojnë në mënyra të ndryshme në komunat e ndryshme në lidhje me implementimin e kontratës publike kornizë të lidhur në mes komunave dhe KosovaMed-it, e me qëllimin e vetëm që ta dëmtojë operatorin ekonomik KosovaMed,

dhe po ashtu të ju mohoj realizimin e të drejtës në punë të gjithë punëtorëve të angazhuar nga KosovaMed.

Sa i përket pikës IV të dispozitivit të këtij kallëzimi penal, në lidhje me dyshimin e arsyeshëm se e dyshuara Nora Kursani Demjaha, i dërgon e-mail zyrtar Drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Drenasit dhe e urdhëron Drejtoreshën që të mos lejoj vazhdimin e Kontratës Publike Kornizë me të Dëmtuarin duke e ditur që i Dëmtuari ka parashtruar Ankesë kundër Vendimit të Inspektoriatit Shëndetësor dhe se Ankesa e pezullon efektin juridik të Vendimit të Inspektoriatit Shëndetësor, si shkallë e parë, deri sa të vendoset përfundimisht nga Shkalla e Dytë, më duhet të cekë si në vijim.

E dyshuara Nora Kursani Demjaha, më datë 15.11.2023, duke qenë e vetëdijshme që i Dëmtuari ka parashtruar Ankesë kundër Vendimit të Inspektoriatit Shëndetësor e gjithashtu duke qenë e vetëdijshme që kjo Ankesë ka efekt suspensiv, urdhëron nëpërmjet email, Ismet Bogiqin Drejtor i QKMF Drenas dhe Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Drenas-it, që të mos vazhdojë të zbatojë Kontratën Publike Kornizë me të Dëmtuarin, pa u mbështetur në asnjë argument ligjor. Drejtori i QKMF dhe Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë, e kanë respektuar urdhrin e të dyshuarës Nora Kursani Demjaha.

Më duhet të cekë një paragraf nga ky email ku Dr. Nora Kursani Demjaha i shkruan Drejtorit të QKMF-së Drenas dhe Drejtoreshës së Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Drenasit z.Lumnije Krapë, si në vazhdim nën post scriptum; P.S. Për informimin tuaj, OE "KosovaMedHelathCare SH.P.K" ka Vendim të datës 27.10.2023 nga Inspektorati Shëndetësor me të cilin i është ndaluar ofrimi i Shërbimeve Shëndetësore.

Shtojca nr.9 Emaili i datës 15.11.2023 dërguar nga Nora Kursani Drejtorit të QKMF-së dhe Drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë.

Me këto veprime, e dyshuara Nora Kursani Demjaha ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i Detyrës Zyrtare, për arsye se nuk ka pasur asnjë lloj autoriteti apo kompetence që të urdhërojë Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunë ne Drenasit, që të mos vazhdojë Kontratën Publike Kornizë me të Dëmtuarin ,sepse ajo Kontratë është lidhur sipas procedurave të prokurimit publik ndërmjet të Dëmtuarit dhe Komunës së Drenasit, ndërkaq, për procedurën inspektuese, është dashur që të presë Vendimin e Shkallës së

Dytë, e jo të urdhërojë një Drejtoreshë të një Komune, që të mos veprojë sipas Ligjit, por ta zbatojë urdhërin e të dyshuarës.

E tërë kjo situatë sqarohet në mënyrën më të mirë nga emaili i datës 24.01.2024, të cilin e-mail e dërgon Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Drenasit, z.Lumnije Krapë, për Nora Kursani Demjaha dhe pranuesve të tjerë, ku ndër të tjera ceket si në vijim: Komuna e Drenasit dhe kompania Kosova Med Health Cae kanë lidhur kontratë kornizë me nr. të prokurimit 611-21-2552-2-1-1 për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Inspektorati shëndetësor me datë 27/10/2023 kishte lëshuar rekomandimin nr.10-05-2228 për pezullimin e shërbimeve të cilat i ofron kjo kompani për komunën e Drenasit, me arsyetimin se kjo kompani nuk kishte licencë valide të punës për ofrimin e këtyre shërbimeve. Me datë 05/11/2023, komuna e Drenasit kishte kërkuar vazhdimin e shërbimeve, mirëpo edhe përkundër kësaj Inspektorati shëndetësor me saktësisht zv.Znj.Dr. Nora Kursani-Demjaha, Zëvendësues i Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor, me datë 15.11.2023 i kishte kërkuar Komunës së Drenasit zbatimin e rekomandimit, duke paralajmëruar edhe pasoja ligjore për komunën nëse nuk e respekton rekomandimin e Inspektoriatit. Me datë 24/01/2024 komuna e Drenasit ka pranuar vendimin Nr:10-05-76, ku shihet që veprimet e Inspektoratit Shëndetësor kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, rrjedhimisht Komuna e Drenasit kontratën me kompaninë e lartcekur e ka pasur në përputhje të plotë me ligjet e aplikueshme.

Për fund ju informojmë se komuna e Drenasit në bazë të kompetencave të saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi do ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që për dëmet e shkaktuara si në aspektin financiar ashtu edhe në imazhin e komunës së Drenasit të kërkojë llogari nga të gjithë ata që ishin të përfshirë në këtë çështje, kur kemi parasysh që me këto veprime Komuna e Drenasit është dëmtuar jashtëzakonisht shumë.

Shtojcë nr.10 e-maili i datës 24.01.2024 dërguar nga Lumnije Krapë.

Shkëmbimet e email ndërmjet të dyshuarës znj. Nora Kursani Demjaha dhe Drejtorisë së Shëndetësisë të Komunës së Drenasit, vijojnë, ku e dyshuara i qëndron prapa të gjitha pretendimeve të saja për të mos vazhduar me punë, pavarësisht se e dinte që lidhur me këto procedura administrative, i dëmtuari kishte paraqitur ankesë që ka efekt suspensiv ndaj Vendimeve të Inspektoriatit Shëndetësor.

Shtojcë nr.11, ankesa e operatorit ekonomik KosovaMed e protokolluar me datë 06.11.2023.

Shtojcë nr.12, E-maile të komunikimeve në mesë të personave të involvuar në këtë rast, përveç emaileve të lartcekura; Vendimi i Shkalles se Dyte per QKMF – Kline dhe Raportet per QKMF – Skenderaj dhe QKMF – Malisheve, qe konstatohet qe veprimtaria e te demtuarit eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

Andaj, nga të larë cekurat propozojmë që ndaj të dyshuarve të fillohen hetimet në drejtim të veprës penale Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar.

Prishtinë
02.04.2024

Kastriot Asllani



Shtojcë kallëzimit penal:

1. Shtojcë nr.1, Kontrata Publike Kornizë me numër 611-21-2552-2-1-1/C430.
2. Shtojcë nr.2, Procesverbali i Kontrollit të Inspeksionit të AKPPM-së i datës 11.10.2023.
3. Shtojcë nr.3, Procesverbali i kontrollit të inspeksionit shëndetësor me nr. 02450, i datës 17.10.2023.
4. Shtojca nr.4, Raporti i Inspektimit i datës 27.10.2023.
5. Shtojca nr.5 Procesverbali mbi inspektimin e kryer me numër 01251 i datës 11.10.2023.
6. Shtojcë nr.6 Vendimi me nr. 10/H-10-23, i datës 27.10.2023 për QKMF – Drenas, Vendimi me nr. 10/NY-104-23 dt. 15.11.2023 për QKMF – Klinë dhe Raporti i Inspektimit në QKMF – Klinë.
7. Shtojcë nr.7, Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e ankesave të Inspektoratit Shëndetësor me nr.10/KA-001/24 i datës 19.01.2024.

8. Shtojcë nr.8 dëshmia e pagesës së pagave për dy muaj për punëtorët e angazhuar nga KosovaMed.
9. Shtojca nr.9 Emaili i datës 15.11.2023 dërguar nga Nora Kursani Demjaha, Drejtorit të QKMF-së dhe Drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë.
10. Shtojcë nr.10 e-maili i datës 24.01.2024 dërguar nga Lumnije Krapit.
11. Shtojcë nr.11, ankesa e operatorit ekonomik KosovaMed e protokolluar me datë 06.11.2023.
12. Shtojcë nr.12, E-maile të komunikimeve në mesë të personave të involvuar në këtë rast, përveç emaileve të lartcekura; Vendimi i Shkalles së Dytë për QKMF – Kline dhe Raportet për QKMF – Skenderaj dhe QKMF – Malisheve, që konstatohet që veprimtaria e të demtuarit është në përputhje me legjislacionin në fuqi